



TEL: +38349510007 dhe +38344364106

e mail: [kosovajudo@hotmail.com](mailto:kosovajudo@hotmail.com)

## **RAPORT**

### **Seminari per Trajner dhe Refer**

**Peje, Kosove**

**18 Janar 2020**

Ne palestren e xhudos “Ippon” ne Peje si gjithmone pas Kampionatit te Kosoves per Seniore u mbajt Seminari per Trajner dhe Refer.

Seminari ne fjale u mbajt pas perfundimit te Kampionitit te Kosoves per Senior per shkak se aty ishin te gjitha te pranishem, si trajneret ashtu edhe referet.

Seminari si zakonisht u udhehoq nga Driton Kuka ne rolin e trajnerit dhe Fatmir Salihaj ne rolin e referit te cilet kane qene pjesemarres ne garat e ndryshme te IJF-se dhe EJU-se e poashtu ne Kampe te ndryshme kombetare e nderkombetare.

Gjate ketij Seminari pati diskutime te shumta teorike dhe praktike, cka lejohet e cka nuk lejohet.

Udheheqesit e seminarit ishin te gatshem te pergjigjen ne pyetjet e ndryshme te pjesemarresve te pranishem.

Ne menyre praktike u demonstruan rregullat dhe cka po rezulton deri te denimi ne xhudo.

Nder pikat kryesore qe u diskutuan ne kete Seminar ishin keto:

Ne cilat raste eshte Wazaari e ne cilat Ippon

Diskualifikim (Hansoku-make) per te dy garuesit

Referi te kete bashkepunim dhe te konsultohet me komisionin ne rastet diskutabile

Te vazhdohet te punohet sic eshte punuar deri me tani

Te punohet ne promovimin dhe masovizimin e xhudos

Poenat dhe vleresimi i drejte i tyre gjate garave

Nder te tjera u diskutuan edhe pozicione te ndryshme te lejuara dhe te ndaluara ne ndeshjen e xhudos ne toke (ne-waza)

Seminari per Trajner dhe Refer qe u mbajt ishte shume produktiv e frutdhenes dhe te gjithë u ndane te kenaqur me menyren e demonstrimit dhe ligjerimit ne pergjithesi.

Peje, 18.01.2020

Federata e xhudos se Kosoves